



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE TË  
KOMUNËS SË SKËNDERAJT  
PËR VITIN 2019**

**Prishtinë, korrik 2020**

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë llogaridhënien e institucioneve publike, duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur për opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të *Komunës së Skënderajt*, në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm *Naser Arllati*, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga *Ylber Sadiku* udhëheqës ekipi, *Fisnik Rudaj* anëtar dhe *Muharrem Qyqalla* anëtar, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit *Bujar Bajraktari*.

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit .....	5
1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore .....	6
2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli .....	8
3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	29
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja .....	35
Shtojca II: Letër e konfirmimit .....	37

## Përmbledhje e përgjithshme

Raporti i përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Komunës së Skënderajt për vitin 2019, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i Pasqyrave Financiare për vitin 2019 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA).

Auditimi është fokusuar në:



### Konkluzionet

**Konkluzioni për Pasqyrat Financiare Vjetore** - Pasqyrat Financiare janë përgatitur në pajtim me rregullat dhe Standardet e zbatueshme, me përjashtim të keq-klasifikimit të shpenzimeve në mes të kategorive ekonomike. Kjo është shpjeguar tek Paragrafi për Theksimin e çështjes. Poashtu kishte disa dobësi në shpalosjen e pasurive jo financiare.

**Konkluzioni për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin** - Edhe pse kontrollet e brendshme kanë operuar në mënyrë efektive në disa fusha, menaxhimi financiar dhe kontrolli është përcjellë me dobësi evidente në disa sisteme të rëndësishme financiare. Kontrollet mbi shpenzimet kërkojnë përmirësim të mëtejshëm për të parandaluar keqklasifikimin e shpenzimeve, shmangien e pagesave me vendime gjyqësore, anashkalimin e rregullave të prokurimit, menaxhimin e projekteve kapitale si dhe menaxhimin e pasurive.

**Konkluzioni për zbatimin e rekomandimeve nga viti paraprak** - Zbatimi i rekomandimeve të vitit paraprak nuk monitorohet në nivelin e duhur, dhe nuk ka progres të mjaftueshëm në zbatimin e tyre. Përkundër veprimeve të ndërmarra, ka nevojë për veprime shtesë për zbatimin e rekomandimeve tona.

### Opinion i Auditorit të Përgjithshëm<sup>1</sup>

#### Opinion i pa modifikuar me theksim të çështjes

Më gjerësisht shih kapitullin 1 të këtij raporti.

### Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2019

Kryetari është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna. Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të Komunës gjatë procesit të auditimit.

<sup>1</sup> Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

## Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave të tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Auditimi është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Kemi analizuar veprimtarinë e Komunës së Skënderajt, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale, si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që i kemi konsideruar të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Gjetjet e auditimit nuk duhen të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e dobësive që mund të ekzistojnë apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që janë aplikuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përshkrim të detajuar të gjetjeve dhe rekomandimeve në çdo fushë të audituar. Përgjigjet e menaxhmentit në rezultatet e auditimit mund të gjenden në Shtojcën II.

# 1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore

Ne kemi kryer auditimin e PFV-ve së Komunës së Skënderajt për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019, në përputhje me Ligjin e ZKA-së dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Ekzaminimet e auditimit janë kryer për të mundësuar dhënien e opinionit për PFV, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme dhe pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, të shpalosura në detaje.

## Opinion i pa modifikuar me theksim të çështjes

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik të kontabilitetit në para të gatshme.

## Baza për Opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me SNISA-t 10 dhe 30, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga Komuna. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin.

## Theksimi i çështjes

Ne dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se komuna ka paguar dhe regjistruar shpenzime nga kategoritë ekonomike jo adekuate. Përkatësisht, nga buxheti i mallrave dhe shërbimeve si dhe investimeve kapitale janë paguar paga dhe mëditje. Këto pagesa janë kryer nga Thesari në bazë të vendimeve gjyqësore/përmbarimore, dhe kanë të bëjnë me kompensimin e pagave jubilarë dhe përcjellëse me rastin e pensionimit të punonjësve. Komuna ka bërë përpjekje për të evituar këto pagesa por ka qenë e pamundur, për shkak se nuk ka pasur mjete të aprovuara me buxhet për pagesën e tyre.

Po ashtu, përmes planifikimit buxhetor, komuna ka kryer pagesa nga subvencionet dhe transferet për mallra e shërbime dhe anasjelltas. Në këtë raport keqklasifikimet janë trajtuar te nënkapitulli 2.1 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit. Opinioni ynë nuk është modifikuar në lidhje me këtë çështje.

## Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV-të

Kryetari i Komunës së Skënderajt është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për

të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

### **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV-të në bazë të auditimit të kryer, në përputhje me SNISA-t. Këto standarde kërkojnë që të marrim siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keqdeklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keqdeklarim material që mund të ekzistojë. Keqdeklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

Ne komunikojmë me menaxhmentin e entitetit të audituar në lidhje me fushëveprimin, kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Raporti i auditimit publikohet në web faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si të ndjeshme apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore dhe pasuritë e detyrimet si dhe funksionin e auditimit të brendshëm.

### Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat janë në përgjithësi të përshtatshme dhe janë duke u zbatuar në mënyrë efektive. Megjithatë, kontrollet mbi shpenzimet kërkojnë përmirësim të mëtejshëm për të parandaluar: keqklasifikimin e shpenzimeve, ekzekutimin e pagesave përmes vendimeve gjyqësore, anashkalimin e rregullave të prokurimit, mangësitë në menaxhimin e projekteve kapitale si dhe menaxhimin e pasurive jo financiare.

#### 2.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>2</sup>	2019 Realizimi	% e Realizimit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
<b>Burimet e Fondeve:</b>	<b>13,406,283</b>	<b>14,723,789</b>	<b>13,507,214</b>	92	<b>13,033,451</b>	<b>12,065,482</b>
Granti i Qeverisë - Buxheti	12,218,658	12,238,658	11,536,240	94	11,832,370	10,575,442
Huamarrja	177,628	96,754	91,527	95	51,670	-
Të bartura nga viti paraprak <sup>3</sup>	-	815,509	586,075	72	138,213	168,199
Të hyrat vetjake <sup>4</sup>	1,009,997	1,395,364	1,151,988	83	900,975	1,320,642
Donacionet e brendshme	-	7,501	-	-	-	-
Donacionet e jashtme	-	170,003	141,385	83	110,223	1,199

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,317,506€. Kjo rritje ishte rezultat i të hyrave të bartura nga viti paraprak për 815,509€, rritjes së të hyrave vetjake për 385,367€,

<sup>2</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

<sup>3</sup> Të hyrat vetjake të komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual

<sup>4</sup> Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetanake

donacioneve të brendshme për 7,501€, donacioneve të jashtme për 170,003€ si dhe rritjes së grantit të qeverisë për 20,000€. Përderisa, financimi nga huamarrja ishte zvogëluar për 80,874€.

Në vitin 2019, Komuna ka shpenzuar 92% të buxhetit final ose 13,507,214€, me një përmirësim prej rreth 4% krahasuar me vitin 2018. Më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale të realizimit të buxhetit.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2019 Realizimi	% e Realizimit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b>	<b>13,406,283</b>	<b>14,723,789</b>	<b>13,507,214</b>	<b>92</b>	<b>13,033,451</b>	<b>12,065,482</b>
Pagat dhe Mëditjet	7,805,273	7,831,463	7,687,208	98	7,490,289	7,267,204
Mallrat dhe Shërbimet	1,480,640	1,616,433	1,564,420	97	1,374,212	1,042,725
Shërbimet komunale	294,537	295,164	183,249	62	197,121	187,782
Subvencionet dhe Transferet	270,000	582,078	552,047	95	349,047	197,944
Investimet Kapitale	3,555,833	4,398,650	3,520,290	80	3,622,782	3,369,827

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore:

- Buxheti final për paga dhe mëditje ishte rritur për 26,190€ si rezultat i të hyrave të bartura;
- Te mallrat dhe shërbimet, buxheti ishte rritur për 135,793€. Rritja kishte ndodhur nga të hyrat e vetanake për 190,368€, nga të hyrat e bartura për 33,029€ nga grantet e donatorëve 1,696€, përderisa buxheti nga huamarrja ishte zvogëluar për 89,300€. Buxheti për shërbimet komunale ishte rritur për 627€ nga të hyrat e bartura;
- Buxheti për subvencione ishte rritur për 312,078€, rritja kishte ndodhur nga të hyrat vetanake për 195,000€, të hyrat e bartura për 97,000€ si dhe nga rritja e buxhetit sipas vendimit të Qeverisë<sup>5</sup> për 20,000€;
- Buxheti për investimet kapitale ishte rritur për 842,817€, si rezultat i të hyrave të bartura 658,584€, nga grantet e donatoreve 175,807€ si dhe nga huamarrja 8,425€.

<sup>5</sup> Vendimi i Qeverisë 01-2019 të datës 25.04.2019

---

## Çështja C1 - Keq klasifikim i shpenzimeve në kategori ekonomike

### Gjetja

Ligji Nr. 06/L-133 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019 dhe plani kontabël definojnë qartë se shpenzimet duhet të ndodhin nga kategoritë adekuate ekonomike. Gjithashtu UA Nr. 19/2009 për planin kontabël, neni 8.1 dhe 8.3 kanë përcaktuar qëllimin dhe strukturën e planit kontabël, si dhe klasifikimin ekonomik të shpenzimeve të cilat duhen të bëhen sipas kodeve dhe kategorive të caktuara ekonomike.

Siç kemi paraqitur te theksimi i çështjes, komuna ka paguar dhe regjistruar shpenzime për paga në vlerë 150,042€ nga kategori ekonomike jo adekuate. Nga mallrat dhe shërbimet ishin paguar 108,100€, si dhe nga investimet kapitale 41,942€. Këto pagesa janë kryer nga Thesari në bazë të vendimeve gjyqësore/përmbarrimore dhe kanë të bëjnë me kompensimin e pagave jubilarë dhe përcjellëse me rastin e pensionimit të punonjësve. Në një rast tjetër, komuna kishte paguar nga mallrat dhe shërbimet 518€ për një pagë shtesë të një zyrtareje me rastin e pensionimit. Kjo ka ndodhur për shkak se nuk ka pasur mjete të aprovuara me ligjin e buxhetit për pagesën e tyre nga kategoria adekuate. Vlen të ceket se një pjesë e pagave jubilarë/përcjellëse të vitit 2019 janë paguar nga kategoria e pagave, derisa marrëveshja kolektive e punëtorëve të sektorit të shëndetësisë është dërguar nga avokati i komunës në Gjykatën Kushtetuese për të vlerësuar ligjshmërinë e saj

Po ashtu përmes planifikimit të gabuar, komuna kishte kryer pagesa nga kategoritë ekonomike jo adekuate si:

- Nga subvencionet dhe transferet janë paguar 110,155€ për mallra dhe shërbime. Shpenzimet janë realizuar duke u bazuar në Marrëveshjen e bashkëpunimit dhe bashkëfinancimit mes Komunës dhe Caritas Kosova për projektin “Ngritja e përkujdesit për shërbime sociale dhe shëndetësore në shtëpi dhe ambulanta në Komunën e Skënderajt”.
- Nga mallrat dhe shërbimet janë paguar 40,745€ për subvencione dhe transfere, respektivisht për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për qytetarët në bazë të Memorandumit të Mirëkuptimit mes Komunës dhe Këshillit të Bashkësisë Islame për kryerjen e riteve fetare të varrimit si dhe shërbimeve dhe ceremonive përcjellëse.

Kjo ka ndodhur për shkak të planifikimit të dobët të buxhetit nga ana e komunës dhe aprovimit nga MF dhe Kuvendi i Republikës së Kosovës.

### Ndikimi

Keq klasifikimi i shpenzimeve rezulton me pasqyrimin jo të drejtë të shpenzimeve në PFV, dhe rrjedhimisht shpie në keqkuptim të aktiviteteve financiare të komunës.

**Rekomandimi C1** Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet/kategoritë adekuate të buxhetit (apo të ridestinohen mjetet kur është e nevojshme dhe e mundëshme), dhe që pagesa e regjistrimi i shpenzimeve të bëhet në mënyrë strikte sipas kodeve ekonomike adekuate.

### 2.1.1 Të hyrat

Të hyrat e përgjithshme të realizuara nga Komuna e Skënderajit në vitin 2019 ishin 1,548,529€ apo rreth 2% më pak se vitin paraprak. Të hyrat kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, të hyrat nga koncesionet, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Komuna kishte edhe të hyra të arkëtuara nga institucionet tjera në emër të komunës si në vijim: gjobat në trafik 119,000€, dhe gjobat nga gjykatat 4,000€. Poashtu komuna kishte pranuar donacione në vlerë 141,890€.

**Tabela 3. Të hyrat(në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2019 Pranimet	% e Realizimit 2019	2018 Pranimet	2017 Pranimet
<b>Të hyrat vetjake</b>	<b>1,009,996</b>	<b>1,395,364</b>	<b>1,548,529</b>	<b>111</b>	<b>1,575,503</b>	<b>1,413,200</b>
Të hyrat tatimore	282,796	219,796	272,869	124	222,450	170,108
Të hyrat jo tatimore	727,200	1,175,568	1,275,660	109	1,353,053	1,243,092

Ne kemi testuar 16 mostra për teste substanciale në vlerë 942,670€, dhe 10 mostra për pajtueshmëri. Testimet tona nuk kanë evidentuar ndonjë çështje materiale për tu raportuar.

## 2.1.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje ishte 7,931,463€, prej tyre janë shpenzuar 7,687,208€. Numri i aprovuar i të punësuarve, sipas buxhetit ishte 1,373 ndërsa në fund të vitit numri i tyre ishte 1,256. Gjatë vitit 2019 ishin punësuar 63 punëtor të rinj. Kemi testuar 55 mostra për teste substanciale në vlerë 25,498€, si dhe 8 mostra për teste të pajtueshmërisë.

### Çështja B1 - Dobësitë e identifikuar te kontratat sipas Marrëveshjeve për shërbime të veçanta

**Gjetja** Neni 12 i Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil përcakton se emërimet me afat të caktuar për një periudhë më të shkurtër se gjashtë muaj duhet të bëhen në bazë të kontratave të quajtura “Marrëveshje për shërbime të veçanta” (MSHV) për të cilat zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit.

Komuna gjatë vitit 2019 kishte të angazhuar 11 punonjës me MSHV. Për 9 prej tyre janë zhvilluar procedura të thjeshtësuar të rekrutimit, për 1 kemi vazhdim të afatit të marrëveshjes për gjashtë muaj përtej afatit ligjor me kërkesë të drejtorisë përkatës, si dhe një 1 punonjës ishte i angazhuar përmes vendimit të kryetarit<sup>6</sup>.

Arsyeja pse janë lidhur këto marrëveshje ishte mungesa e planifikimit buxhetor për këto pozita dhe mundësia më e lehtë e angazhimit përkundër faktit se tri nga këto marrëveshje ishin për pozita të rregullta<sup>7</sup>.

**Ndikimi** Mbulimi i pozitave të rregullta me MSHV rrit rrezikun që punët të mos kryhen me cilësinë e duhur. Ndërsa, vazhdimi i këtyre marrëveshjeve pa procedura të reja kufizon konkurrencën dhe si pasojë mund të pranohet staf me kompetencë jo të duhur.

**Rekomandimi B1** Kryetari duhet të siguroj se MSHV përdorën vetëm për punë specifike dhe kontratat nuk zgjasin më shumë se afati i paraparë ligjor. Po ashtu, duhet të ndërmerren veprime që nevojat për pozitat të rregullta të adresohen në Ministri të Financave gjatë planifikimit buxhetor dhe të sigurohet se buxhetohen dhe paguhen nga kategoria e pagave e mëditjeve.

<sup>6</sup> Vendim mbi emërimin e zëdhënësës së Komunes, i bazuar në Rregulloren 27/2018. Në pamundësi të hyrjes në listën e rregullt të pagave për shkak të mungesës së kodit të pozitës, punonjësja është angazhuar përmes marrëveshjes për shërbime të veçanta.

<sup>7</sup> Asistent administrativë, zyrtar i larte profesional dhe ndihmës teknik.

### 2.1.3 Mallrat dhe shërbimet

Buxheti final për mallra dhe shërbime (përfshirë shërbimet komunale) në vitin 2019 ishte 1,911,597€, prej tyre ishin shpenzuar 1,747,669€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me shërbime kontraktuese, shërbime komunale, furnizime të ndryshme për zyre, mirëmbajtjen e objekteve dhe pajisjeve etj. Kemi testuar 36 mostra për teste substanciale në vlerë 466,929€ si dhe 7 mostra për teste të pajtueshmërisë.

#### Çështja B2 - Vlera të paqarta dhe tejkallim i pagesave për kontratat publike kornizë

##### Gjetja

Neni 22 i Ligjit 05/L-068<sup>8</sup> për prokurimin publik përcakton se vlera e kontratave publike kornizë nuk mund të jetë më e lartë se plus/minus 30% e vlerës totale indikative të saj. Në dy kontrata publike kornizë kemi hasur tejkallime të vlerës indikative së kontratave, përkatësisht te:

- Kontrata “Furnizimi me mallra dhe shërbime për nevojat e drejtorive të Komunës së Skënderajt” e datës 14.09.2017, vlera indikative e kontratës është 13,720€, përderisa vlera totale e pagesave është 43,813€ dhe ka tejkallim mbi vlerën 30% në vlerë prej 25,977€;
- Kontrata “Furnizim me material zyrtar për Komunën e Skënderajt” e datës 16.08.2017, vlera indikative e kontratës është 110,380€, përderisa vlera totale e pagesave është 197,695€ dhe ka tejkallim mbi vlerën 30% në vlerë prej 54,201€;

Po ashtu, gjatë ekzaminimeve tona, kemi hasur në dy kontrata publike kornizë të cilat ishin të paqarta sa i përket vlerës së tyre, ngase në kuadër të paramasës dhe parallogarisë së tyre ka pozicione ku ishin paraparë çmimet për sasi indikative po ashtu çmime për një njësi (sasia 1). Kjo e bën të paqartë nëse shuma totale tek specifikacioni i çmimeve duhet të jetë vlerë e kontratës apo vlera e kontratës duhet të jetë vlera e parashikuar e saj. Kjo po ashtu e bën më të vështirë edhe menaxhimin e këtyre kontratave. Përkatësisht kjo gjendje është identifikuar te::

- Kontrata “Mirëmbajta e rrugëve në sezonin dimëror në Komunën e Skënderajt” Lot I” e datës 19.12.2017, ku thuhet se vlera indikative e kontratës është 8,606€, ndërsa vlera e parashikuar e kontratës ishte 170,000€.

<sup>8</sup> Ligji i Prokurimit Publik nr. 04/L-042 me plotësime dhe ndryshime të ligjeve nr.04/L-237; nr. 05/L-068 dhe 05/L-092 - Neni 22 i këtij ligji ndër të tjera thotë se: Sasia e parashikuar e specifikuar në dokumentet e tenderit është vetëm sasi indikative. Autoriteti kontraktues do të specifikojë në dosjen e tenderit vlerën ose sasinë e kontratës si një prag apo një tavan dhe do të lejojë derivim prej tij, duke deklaruar gjithashtu përqindjen e mospërputhjes së lejuar. Mospërputhja e lejuar nuk mund të jetë më e lartë se plus/minus tridhjetë përqind (30%). Nëse urdhërblertet tejkalojnë sasinë totale indikative ose vlerën totale indikative të kontratës publike kornizë (duke përfshirë + tridhjetë përqind (30%)), pa marrë parasysh datën origjinale të skadimit të Kontratës Publike Kornizë, kontrata do të ndërpritet automatikisht.

- Kontrata "Mirëmbajta e rrugëve në sezonin dimëror në Komunën e Skenderajt Lot II" e datës 31.01.2018, ku vlera indikative e kontratës është 7,423€, ndërsa vlera e parashikuar e kontratës ishte 170,000€.

Këto tejkalime kanë ndodhur për shkak gabimit në hartimin e kontratave nga zyra e prokurimit, në të cilat mundësia e devijimit +/-30% ishte lejuar në vlerën e parashikuar të kontratës (të përcaktuar në njoftimin për kontratë) përderisa është dashur të përcaktohej në vlerën indikative të kontratës e cila është vlera e ofertës financiare. Përkundër zotimeve dhe disa përpjekjeve të Komunës kjo çështje ka mbetur e pa adresuar.

### **Ndikimi**

Nënshkrimi i kontratave të paqarta sa i përket çmimit dhe sasive, e bën të vështirë menaxhimin e tyre dhe mund të shpie në tejkalimin e tyre përtej planifikimit. Derisa tejkalimi i vlerës tek kontratat kornizë përveç dëmtimin e buxhetit të komunës me pagesa të parregullta, mund të rezultojë edhe me mungesë të buxhetit për realizimin e projekteve tjera të parapara.

### **Rekomandimi B2**

Kryetari i komunës duhet sigurohet se gjatë përgatitjes së kontratave publike kornizë nga zyra e prokurimit, të përcaktohen saktë njësitë dhe çmimet e kontratave, devijimi +/-30% të përcaktohet në vlerën indikative e jo në vlerën e parashikuar të kontratës, si dhe të marrë të gjitha masat e nevojshme që përmes raporteve periodike nga menaxherët e kontratave të mënjahen tejkalimet eventuale të kontratave.

### **Çështja C2 - Mangësi në menaxhimin e kontratave**

#### **Gjetja**

Neni 81 i Ligjit nr.04/L-042 për Prokurim Publik si dhe pika 61 e Rregullave të Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik (RrUOPP) përcaktojnë përgjegjësitë e menaxherit të projektit. Një ndër përgjegjësitë e Menaxherit të Kontratës është raportimi në lidhje me realizimin e kontratës. Kemi evidentuar dy raste në të cilat pagesat janë ekzekutuar në mungesë të raporteve të menaxherëve të kontratave, përkatësisht:

- Pagesa në vlerë 5,360€, ku pjesë përbërëse të lëndës janë 25 fatura, në bazë të kontratës "Furnizim me ushqim dhe pije, material higjeniko-sanitar", dhe
- Pagesa në vlerë 3,843€ në bazë të kontratës "Furnizimin me mallra dhe shërbime për nevojat e drejtorive në komunë".

Për pagesën e parë menaxheri është arsyetuar në atë që nuk e ka parë të arsyeshme bërjen e raportit, kurse për pagesën e dytë ishte për shkak që kontrata nuk ka pasur menaxher në kohën kur është bërë furnizimi.

---

**Ndikimi** Mos hartimi i raporteve nga menaxherët e kontratave mund të ndikojë në menaxhim të dobët të kontratave si dhe mund të rezultojë me pagesa të pa rregullta.

**Rekomandimi C2** Kryetari duhet të siguroj që menaxhimi i kontratave bëhet përmes hartimit të raporteve nga menaxherët përkatës për çdo lloj shërbimi dhe furnizimi, dhe se asnjë pagesë të mos ekzekutohet pa u siguruar dëshmitë e mjaftueshme se dispozitat e kontratës po zbatohen nga ana e operatorëve ekonomik (OE).

### Çështja A1 - Mangësi në menaxhimin dhe pagesën e kontratës

**Gjetja** Sipas kontratës një vjeçare “Mirëmbajta e aparateve Hematologjike-Medonike, në QKMF - Komuna Skënderaj” të datës 09.09.2019, parashihet mirëmbajta e shtatë (7) aparateve të tilla, me çmim për njësi 1,425€, dhe çmim total të kontratës 9,975€.

Gjatë testimit pagesave të kësaj kontrate (5,000€ dhe 4,975€), kemi konstatuar që është bërë ekzekutimi i komplet vlerës së kontratës pa u kryer të gjitha shërbimet e parapara me kontratë. Përkatësisht, deri në kohën e pagesave ishin servisuar vetëm katër (4) aparate, kurse pagesat janë bërë për totalin e kontratës (7 aparate). Rrjedhimisht vlera reale e shërbimeve të kryera ishte 5,700€ duke rezultuar me mbi pagesë prej 4,275€. Gjatë ekzekutimit të auditimit (qershor 2020) kemi marrë dëshmi që procesi i mirëmbajtës të aparateve ka vazhduar pa ndonjë pengesë nga OE dhe servisimi i aparatit të 6 ishte në proces.

Kjo ka ndodhur ngase ka pasur një pa qartësi dhe mungesë informacioni edhe nga menaxheri i kontratës në raportin e tij, si dhe për shkak të volumit të madh të punëve të fund të vitit në zyrën e financave.

**Ndikimi** Ekzekutimi i pagesave pa pranuar shërbimet/furnizimet paraqet pagesë të parregullt dhe mund të rezultojë me dëmtim të buxhetit si dhe keqpërdorim të parasë publike.

**Rekomandimi A1** Kryetari duhet sigurojë që do të kryhet servisimi i të gjitha aparateve të parapara sipas kontratës, dhe se zyrtarët përgjegjës në menaxhimin e kontratave dhe çertifikim të pagesave aplikojnë kontrolle efektive në procesin e shpenzimit të parasë publike për tu siguruar se në të ardhmen nuk do të përseriten gabimet e ngjashme.

---

## Çështja A2- Mangësi në procesin e prokurimit

### Gjetja

Gjatë procesit të vlerësimit të tenderit për dy aktivitete të prokurimit, nuk janë përdorur rrugët ligjore për kërkimin e dëshmimeve shtesë për sqarimin e tenderëve siç është formulari standard B47 “Kërkesë për sqarim të tenderit”. Sipas RrUOPP pika 39.1, kërkesa për sqarim dhe përgjigja duhet të bëhet përmes platformës elektronike. Përkatësisht:

- Në aktivitetin e prokurimit “Furnizimi me ushqim dhe pije, material higjieniko-sanitar për institucione të AK Skënderaj”, dëshmitë shtesë si raportet e pranimit dhe referencat për listën e kontratave të ngjashme të realizuara janë kërkuar përmes telefonit dhe janë pranuar kopje fizike. Për më tepër me rastin e përgatitjes së dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë nuk është respektuar neni 69 i LPP-së për kërkimin e dëshmisë e kërkuar dokumentare tek kapaciteti teknik dhe profesional.
- Në aktivitetin e prokurimit “Furnizim me llaptop, kompjuter komplet, printerë, UPS, aparat digjital dhe pjesë të tjera, për AK Skënderaj”, dëshmitë shtesë të përvojës së menaxherit të projektit dhe marrëveshja për angazhimin e stafit profesional janë pranuar përmes emailit.

Këto kanë ndodhur për shkak të pakujdesisë së zyrtarit përgjegjës të prokurimit dhe mungesës së njohurive të komisioneve vlerësuese lidhur me kërkesat ligjore për sqarimin e tenderëve (kërkimin e dëshmimeve shtesë).

### Ndikimi

Mos kërkimi i sqarimeve shtesë përmes rrugëve ligjore, rritë rrezikun që të pranohen dokumente të cilat nuk prezantojnë gjendjen ekzistuese para datës së publikimit të njoftimit për kontratë. Ndërsa, mos ndjekja e kërkesave ligjore të prokurimit gjatë përgatitjes së dosjes së tenderit/njoftimit për kontratë mund të ndikojë përmbushjen e kontratës në të ardhmen.

**Rekomandimi A2** Kryetari duhet të forcojë kontrollin në departamentin e prokurimit, për të siguruar që zyrtaret përgjegjës, të gjitha kërkesat për sqarime të tenderit dhe përgatitjen e dosjeve të tenderit/njoftimit për kontratë t’i bëjnë sipas kritereve të parapara ligjore.

---

## 2.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 582,078€, prej tyre në 2019 ishin shpenzuar 552,047€. Ato janë dhënë për entitete publike dhe jopublike dhe kanë të bëjnë kryesisht me përkrahjen e sektorit të bujqësisë, kulturës, sportit dhe aktiviteteve tjera në kuadër të komunës. Kemi testuar 13 mostra për teste substanciale në vlerë 169,216€ si dhe 5 mostra për teste të pajtueshmërisë.

---

### Çështja A3 - Dobësi në menaxhimin e procedurave për dhënien e subvencioneve

**Gjetja** Kemi testuar thirrjen publike të dt. 24.04.2019 për grante të bërë nga Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (DBZHR), për përfitimin e makinave mjelëse (vlerë 7,560€), serra 100m<sup>2</sup> (14,742€) si dhe moto-kultivator me freza (11,550€). Gjatë shqyrtimit të procesit kemi vërejtur se komisioni për vlerësimin e aplikacioneve, përveç kriterëve të publikuara në thirrjen publike, kishte përdorur edhe disa kriterë tjera mbi të cilat kishte bërë poentimin e aplikuesve sipas vlerësimeve që komisioni i ka bërë në teren. Mirëpo, komisioni nuk e kishte dokumentuar me dëshmi përmbushjen e këtyre kriterëve. Disa nga kriteret të cilat komisioni i ka përdorë e për të cilat nuk ka dëshmi janë: përbërja e familjes (fëmijë 1-8vjeq, pleq>65 vjeç, fëmijë me nevoja të veçanta); punimin e tokës bujqësore (e punon tokën apo pjesërisht e punon tokën bujqësore); gjendjen financiare (rast social, mesatare ose financiarisht e lartë) etj.

Sipas drejtorit për BZHBR, mungesa e dëshmimeve ishte për arsye se ishte konsideruar e panevojshme mbledhja e të gjithë dokumentacionit për shkak të volumit të madh të dëshmimeve dhe shkaktimit të kostos së madhe për aplikuesit gjatë nxjerrjes së këtyre dëshmimeve, derisa kriteret shitesë janë parë si të domosdoshme pasi që kriteret bazë janë plotësuar nga pothuajse të gjithë aplikuesit, dhe është dashur të bëhet një listë më e ngushtë sipas mundësive të komunës për subvencionim.

**Ndikimi** Mos përcaktimi i kriterëve të matshme me rastin e përpilimit të thirrjeve për aplikim ka vështirësuar procesin e vlerësimit, ndërsa mungesa e dëshmimeve për vlerësimin e aplikuesve mund të rezultojë me gabime në përcaktimin e përfituesve, si dhe shton rrezikun e trajtimit jo të barabartë të aplikuesve.

**Rekomandimi A3** Kryetari duhet të sigurojë që procesi i vlerësimit të aplikuesve të dokumentohet me dëshmi përkatëse duke siguruar në të njëjtën kohë të mos shkelet parimi i konkurrencës dhe trajtimit të barabartë të aplikuesve.

---

## 2.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 4,398,650€ prej tyre në 2019 ishin shpenzuar 3,520,290€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me ndërtimin dhe rregullim të infrastrukturës rrugore, ujësjellësit dhe kanalizimeve, ndërtim të shkollave dhe parqeve, shpronësime, blerje të pajisje dhe përmirësime të ndryshme të kapitalit. Kemi testuar 70 mostra për teste substanciale në vlerë 2,441,924€ si dhe 5 mostra për teste të pajtueshmërisë.

### Çështja A4 - Ndryshime në pozicionet e kontratës jo kornizë pa aprovimin paraprak të Zyrtarit Kryesor Administrativ

**Gjetja** Neni 61.21 RrUOPP specifikon se “Ndryshimi i kontratës i referohet një ndryshimi në termat dhe kushtet e një kontrate të shpërblyer”, dhe neni 61.22 thotë se “ndryshimi i kontratës do të përgatitet nga departamenti i prokurimit”, ndërsa neni 61.23 thotë se kjo mund të bëhet “vetëm pas marrjes së aprovimit nga Zyrtarit Kryesor Administrativ”.

Ne kemi vërejtur tre (3) kontrata jo kornizë në të cilat kishte pasur devijime apo ndryshime të sasive të realizuara nëpër disa pozicione, duke rritur/zvogëluar sasinë e kontraktuar, por pa ndryshuar çmimin total të kontratës. Për këto ndryshime nuk ishin marrë aprovimet e nevojshme nga zyra e prokurimit dhe Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) ashtu siç kërkohet me nenet 61.22 dhe 61.23 të RrUOPP. Këto kontrata janë: "Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit në fshatin Polac" me vlerë 488,789€; "Mirëmbajtja dhe zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik, zëvendësimi i trupave ekzistues në LED" me vlerë 269,258€; dhe "Zgjerimi i sheshit Adem Jashari" prej 179,046€.

Mos aprovimi i këtyre ndryshimeve ka ndodhur për shkak se menaxherët e projekteve nuk ishin në njohuri për kërkesat ligjore të prokurimit publik lidhur me ndryshimin e kontratave.

**Ndikimi** Ndryshimi i paramasës dhe paralogarisë së kontraktuar pa aprovimin e zyrës së prokurimit dhe ZKA-së shpërfaq dobësitë në kontrollet e ushtruara nga menaxhmenti i lartë dhe mund të rezultojë që për shkak të realizimit të kontratës me kushte të ndryshuara nuk është përzgjedhur operatori më i lirë.

**Rekomandimi A4** Kryetari duhet të sigurojë se menaxherët e projekteve janë në njohuri me kërkesat ligjore për prokurimin publik (kjo mund të bëhet me anë të trajnimeve) dhe se çdo ndryshim në kushtet e kontratës para ose gjatë periudhës së zbatimit do të bëhet vetëm pas njoftimit të zyrës së prokurimit dhe marrjes së aprovimit nga zyra e prokurimit dhe ZKA.

**Çështja A5 – Nënshkrimi i kontratës pa mjete financiare të mjaftueshme**

**Gjetja** Sipas nenit 12.6 të ligjit të buxhetit për vitin 2019, kërkohet që nënshkrimi i kontratave për projekte kapitale shumëvjeçare të bëhet nga organizatat buxhetore vetëm në rast se shpenzimet e tilla janë të parapara në ligjin e buxhetit për vitin fiskal 2019 dhe për dy (2) vitet në vijim.

Komuna, me datën 14.11.2019 kishte nënshkruar kontratë për "Ndërtimin e poligoneve sportive" me vlerë 54,528€, ku sipas kontratës për vitin 2019 janë paraparë 35,000€ ndërsa për vitin 2020 janë paraparë 19,528€. Mirëpo sipas ligjit të buxhetit për vitin 2019, për këtë projekt janë paraparë 35,000€, ndërsa për vitin 2020 nuk ka mjete të planifikuara për shpenzim. Pra, komuna ka hyrë në obligime kontraktuale në kundërshtim të kërkesat e nenit 12.6 të ligjit të buxhetit 2019.

Kjo gjendje ishte për shkak të mungesës së njohurive lidhur me kërkesat specifike të ligjit të buxhetit.

**Ndikimi** Nënshkrimi i kontratës në mungesë të mjeteve të mjaftueshme mund të pengojë realizimin e kontratës si dhe mund të ndikojë në prolongimin e realizimit të projekteve të planifikuara.

**Rekomandimi A5** Kryetari duhet të sigurojë që kontratat të nënshkruhen vetëm atëherë kur ekzistojnë fonde të mjaftueshme që sigurojnë ekzekutimin e tyre, pa marrë parasysh nëse financimi i tyre është nga të hyrat vetanake apo fonde tjera të financimit.

**Çështja B3 – Mangësi të evidentuara nga ekzaminimi fizik i projekteve kapitale**

**Gjetja** Rregulla financiare Nr. 01/2013 për shpenzimin e parasë publike, nenet 22 deri 26, ndër të tjera përcaktojnë se paraprakisht duhet të bëhet pranimi i mallrave pastaj duhet të bëhet pagesa. Në dy (2) kontrata kemi evidentuar mangësi në menaxhimin e tyre e rrjedhimisht edhe në çertifikimin e pagesave, si në vijim:

- Te kontrata "Renovimi i objekteve shkollore" prej 54,411€ ku pjesë e kësaj janë katër (4) shkolla, ne kemi bërë ekzaminim fizik të punimeve në dy shkolla. Te renovimi i shkollës "Malush Ahmeti" në Rezallë kemi evidentuar disa pozicione të cilat ishin paguar dhe nuk ishin realizuar. Vlera e paguar për këto pozicione ishte 1,345€<sup>9</sup>. Në po të njëjtën shkollë, ishte paguar furnizimi dhe montimi i 8 lavamanëve dhe pasqyrave, mirëpo nga

<sup>9</sup> Përshkrimi i pozicioneve: 2.1 (furnizimi i materialit dhe ngjyrosja e mureve të objektit brenda me ngjyrë vajore-akrilike me pigment në dy shtresa deri në lartësinë 1.6m) në vlerë 77€; pozicioni 2.2 (furnizimi me materiale, gërryerja dhe gletimi i mureve dhe plafonëve me masë rrafshuese me rrjete 160gr/m<sup>2</sup>) prej 138€; pozicioni 3.2 (furnizimi dhe montimi i pisuarëve nga porcelani i klasit të parë) prej 260€; 3.4 (furnizimi dhe instalimi i ndërprerësit 10A 1p me karakteristika B të çkyqjes, tipi Legrand, HAGER apo të ngjashëm) prej 120€; si dhe pozicioni 2.4 (furnizimet dhe punimi i oxhaqeve) prej 750€.

ekzaminimi fizik kemi evidentuar se ishin furnizuar dhe montuar vetëm 6 lavaman dhe 6 pasqyre. Ndërsa në renovimin e shkollës "Ahmet Delia" kemi evidentuar se pozicionet 2.10 (furnizimi dhe montimi i derës rrëshqitëse në hyrjen kryesore të parkingut 150€) dhe pozicioni 2.11 (furnizimi dhe montimi i derës së hyrjes në parcelë 85€) nuk ishin realizuar, por të njëjtat ishin paguar në fund të vitit 2019. Duhet theksuar se pas ekzaminimit fizik (01.06.2020) ishte bërë realizimi i këtyre dy pozicioneve.

- Te pagesa në vlerë 50,000€ për kontratën "Ndërtimi i Shfmu Elena Gjika në Makërmal" ndër të tjera ishte paguar edhe për pozicionin 9.3<sup>10</sup> në vlerë 5,845€, mirëpo, përmes ekzaminimit fizik kemi evidentuar se ky pozicion nuk ishte realizuar. Pagesa është për situacionin nr. 10, kjo pagesë është ekzekutuar me dt. 06.05.2019, ndërsa ekzaminimin fizik e kemi kryer 02.06.2020.

Ndonëse menaxherët e kontratave ishin neglizhent dhe nuk ishin në njohuri me kërkesat ligjore për menaxhimin e kontratave, pagesat për punë ta pakryera kanë ndodhur me qëllim të shfrytëzimit të mjeteve financiare në fund vit dhe me qëllim të mos lejimit që ato të shkonin në suficit.

#### **Ndikimi**

Mangësitë në menaxhimin e kontratave mund të rezultojë në mos realizimin e kontratave sipas kushteve të përcaktuara, ndërsa ekzekutimi i pagesave për punë të pa kryera mund të rezultojë me dëmtim të buxhetit dhe keqpërdorim të parasë publike.

#### **Rekomandimi B3**

Kryetari duhet të siguroj se menaxherët e kontratave dhe çertifikuesi aplikojnë kontrolle efektive në procesin e shpenzimit të parasë publike për tu siguruar se pagesat bëhen vetëm për punët/furnizimet e realizuara. Po ashtu, për punët e pakryera por të paguara, komuna duhet të sigurohet se do të bëhet realizimi i tyre sipas kushteve kontraktuale, në të kundërtën duhet të bëhet kthimi i mjeteve financiare në buxhetin e komunës.

<sup>10</sup> Përshkrimi i pozicionit 9.3: "Dyshemeja e korridorit në qendër dhe korridorit në kat: Furnizimi, vendosja dhe shtrirja e primerit (bazës) EPOXIT Repox 220 në trashësi 1.5mm të cilit duhet ti shtrohet rërë kuarci me fraksion 01.-0.5mm si dhe miell kuarci. Mbushja e dyshemesë me miell kuarci me fraksion 01.-0.5mm deri sa dyshemeja është ende në gjendje të lëngët. Shtrirja e shtresës së epoxitit me ngjyrë Repox 500 + flluskat dekorative".

## Çështja B4 – Vonesa në realizimin e kontratave

### Gjetja

Nga pagesat e testuara kemi evidentuar vonesa në realizimin e dy<sup>11</sup> (2) kontratave të cilat është dashur të përfundonin në vitin 2019, mirëpo ende nuk janë përmbyllur gjatë kohës së kryerjes së auditimit (qershor 2020).

Për këto kontrata nuk kishte kërkesë/aprovim për zgjatjen e afatit për realizimin e kontratave ashtu siç kërkohet nga dosja standarde e tenderit në nenin 18. Po ashtu, nuk kishte aplikim të penaleve.

Vonesat kryesisht ishin për shkak të menaxhimit jo adekuat të komunës lidhur me problemet pronësore, specifike të punëve, kushteve atmosferike etj. Ndërsa mos ndjekja e procedurave për aprovimin e zgjatjes së afateve të realizimit, ishte si mungesë e njohurive të menaxherëve të kontratave lidhur me kërkesat ligjore.

Po ashtu, në një rast kemi evidentuar se komuna ka paguar me shumë se që ishte paraparë me marrëveshjen e bashkëfinancimit për shkak se projekti nuk kishte përfunduar brenda afatit të përcaktuar. Për shkak të vonesave në kryerjen e punëve, për projektin “Ndërtimi i objektit të QKMF-së në Skënderaj” në vlerë 1,286,913€<sup>12</sup>, i cili ishte bashkëfinancim me Ministrinë e Shëndetësisë, komuna ka paguar 60,000€ më shumë se sa ishte marrëveshja e bashkëfinancimit. Kjo ngase, neni 8 i Marrëveshjes së mirëkuptimit mes komunës dhe MSh-së thotë se: “Komuna duhet të ndërmerr të gjitha masat që projekti të përfundoj gjatë vitit buxhetor 2014-2015. Pas këtij afati të gjitha obligimet kalojnë në përgjegjësi të Komunës”. Pra sikur mos të kishte vonesa, kjo pagesë do të bëhej nga Ministria e Shëndetësisë.

Kjo gjendje ishte për shkak të vonesave dhe menaxhimit jo adekuat të këtij projekti dhe aktiviteteve të ndërlidhura me të. Sipas menaxherit dhe mbikëqyrësit të këtij projekti, arsyet e vonesave janë për shkak të: punëve shtesë dhe të papaparara që kanë dalë gjatë realizimit, dhe për shkak të punëve në oborrin e QKMF-së të cilat janë bërë njëkohësisht nga një operator tjetër, etj.

### Ndikimi

Vonesat në kryerjen e projekteve ndikojnë në rritjen e obligimeve kontraktuale të cilat pastaj bëhen barrë për buxhetin e vitit pasues. Kjo poashtu ndikon në performancën dhe në arritjen e objektivave të përcaktuara të Komunës ngase, pagesat për kostot e paplanifikuara mund të ndikojë në realizimin e projekteve tjera për shkak se këto mjete do të mund të destinoheshin për projektet e reja kapitale.

<sup>11</sup> Kontrata e dt. 02.10.2019 për "Kanalizimi me segmente në qytet" prej 59,242.38€ - afati për realizimin e kontratës 40 dite pune; Kontrata e vitit 30.11.2016 për “Ndërtimin e kanalizimit në Llaushë” në vlerë 738,318.25€ - afati për realizimin e kontratës ishte 30.11.2019

<sup>12</sup> Sipas marrëveshjes së mirëkuptimit MSh participon me 1,000,000€ dhe komuna me 186,913€.

**Rekomandimi B4** Kryetari duhet të siguroj që mos të fillohen projektet pa u siguruar për çështjet e problemeve pronësore. Të hartohen specifika adekuate të projekteve dhe menaxherët e kontratave të aplikojnë kontrole efektive në menaxhimin e kontratave për tu siguruar se ato menaxhohen sipas planifikimeve të bëra paraprakisht. Duhet formalizuar procesin e zgjatjes së periudhës së ekzekutimit të kontratës sipas nenit 18 të dosjes së tenderit, si dhe të aplikohen penalet për vonesat e pa arsyetuara.

## 2.1.6 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet, si dhe investimet kapitale

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet, si dhe investimet kapitale:

### Çështja B5 - Shpenzime të larta procedurale të pagesave të ekzekutuara sipas vendimeve gjyqësore

**Gjetja** Sipas Nenit 39 të LMFP-së, çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim të mallrave dhe shërbimeve të furnizuara ose punëve të realizuara duhet të paguhet brenda 30 ditëve kalendrike pas pranimit të faturës ose kërkesës së vlefshme për pagesë. Po ashtu Ligji Nr. 06/L-133 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019 dhe plani kontabël definojnë qartë se shpenzimet duhet të ndodhin nga kategoritë adekuate ekonomike.

Ne kemi identifikuar se Thesari kishte ekzekutuar në bazë të vendimeve gjyqësore pagesa në vlerë prej 216,928€. Kjo formë e pagesave, përveç ndikimit në keqklasifikimin e shpenzimeve (që është trajtuar tek opinioni i auditimit), ka ndikuar edhe në rritjen e shpenzimeve, ngase borxhi kryesor ndaj pretenduesve ishte 181,202€ ndërsa shpenzimet procedurale të përmbartimit ishin 35,726€.

Pagesat kishin të bëjnë kryesisht me detyrimet e dala nga marrëveshja kolektive për kompensimin e tri pagave jubilarë dhe tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit të punonjësve si dhe një pjesë me operator ekonomik dhe çështje të problemeve pronësore.

Arsyet e ekzekutimit të pagesave të tilla vijnë si rezultat i planifikimit të dobët dhe mungesës së buxhetit nga drejtoritë përkatëse për këto raste.

**Ndikimi** Situata e krijuar që pagesat të ekzekutohen direkt nga ana e Thesarit përmes procedurave të përmbartimit ka ndikuar në rritjen e kostos për Komunën dhe në keqklasifikimin e shpenzimeve.

**Rekomandimi B5** Kryetari duhet të sigurojë bashkëpunim me MF ashtu që obligimet që dalin nga marrëveshja kolektive të planifikohen/buxhetohen dhe paguhen në kohën e duhur nga kategoria e pagave dhe mëditjeve. Gjithashtu obligimet të paguhen brenda afateve kohore të parapara ligjore sipas LMFP.

## 2.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e pasurive kapitale, e paraqitur në PFV ishte 152,207,348€, pasurive jo kapitale ishte 669,000€, dhe e stoqeve 39,889€. Kemi testuar 107 mostra në vlerë 2,818,662€ për teste substanciale, si dhe kemi kryer teste të pajtueshmërisë lidhur me procedurat e brendshme të menaxhimit të pasurive, inventarizimin dhe vlerësimin e pasurive, funksionimin e sistemit e-pasuria etj.

### Çështja C3 - Mangësi në regjistrin kontabël të pasurive

**Gjetja** Testimet për këtë fushë kanë rezultuar me disa mangësi dhe të cilat janë trajtuar si në vijim:

- Neni 6.1 i Rregullores për 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare kërkon që çdo organizatë buxhetore të krijojë dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj. Po ashtu sipas nenit 6.3: Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin e-pasuria. Kemi evidentuar 17 pagesa për blerjen e pasurive kapitale dhe jo kapitale prej 152,476€ të cilat nuk ishin regjistruar në regjistrin e pasurive jo financiare (prej tyre 3 pagesa<sup>13</sup> me vlerë 138,947€ nuk janë regjistruar në SIMFK dhe 14 pagesa<sup>14</sup> prej 13,529€ në e-pasuria). Vlen të potencohet fakti se këto pasuri janë regjistruar në vitin 2020. Ndërlidhur me këtë kemi vërejtur se ende ka probleme me funksionimin e “e-pasurisë” ngase në disa raste nuk aplikon zhvlerësimin, si rezultat nuk mund të marrim siguri nga të dhënat e gjeneruara nga ky sistem.
- Komuna ka kryer procesin e inventarizimit të pasurive jo financiare, mirëpo nuk është bërë krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare ashtu siç kërkohet me nenin 19.4.3 të Rregullores 02/2013. Po ashtu nuk ishte bërë vlerësimi i pasurive jo financiare.

<sup>13</sup> Kanalizimi në Qirez 115,000€; Ndërtimi i rrugëve lokale 6,627.32€ dhe Shpronësimet e tokës 17,320€.

<sup>14</sup> Kompjuter 810€; Pajisje tjera 2,006€; Pajisje tjera 855€; Kompjuter 1,195€; Kompjuter 190€; Kompjuter 720€; Pajisje tjera 705€; Kompjuter 795€; Pajisje tjera 640€; Kompjuter 1,240€; Kompjuter 490€; Kompjuter 1,294€; Pajisje tjera 2,260€ dhe Kompjuter 329€.

- Sipas nenit 11 të Rregullores Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare, pasuritë që gjenden në fazën e investimeve në vijim duhet të regjistrohen në kategorinë e investimeve në vijim, ndërsa pas përfundimit të procesit të investimit, pasuria kapitale do të klasifikohet si pasuri në përdorim dhe për të do të zbatohet zhvlerësimi. Kemi evidentuar 8 pagesa<sup>15</sup> me vlerë 154,659€, të cilat ishin regjistruar si investim në vijim ndërsa është dashur të regjistrohen si pasuri në përdorim për arsye se projektet kishin përfunduar dhe ishin bërë pranimet teknike. Në anën tjetër pagesa prej 50,000€ për kontratën "Ndërtimi i shkollës Elena Gjika në Makërmal" ishte regjistruar si pasuri në përdorim përderisa është dashur të regjistrohej si investim në vijim, ngase ende nuk kishte përfunduar faza e investimeve.
- Dy pagesa<sup>16</sup> prej 14,999€ në regjistrin e pasurive kapitale ishin regjistruar si artikuj të ri, ndonëse ato ishin përmirësime të pasurive ekzistuese. Kjo bie ndesh me nenin 15.2 të udhëzuesit për menaxhimin e pasurive i cili kërkon që përmirësimet të regjistrohen si rritje e vlerës së pasurive jo financiare kapitale. Përveç kësaj, regjistrimi ishte bërë gabimisht në klasën e pasurive "Ndërtimi i rrugëve lokale - 31230" ndërsa është dashur të regjistroheshin në klasën e pasurive "Objektet arsimore - 31121
- Në dy raste kemi hasur mbivlerësim të regjistrit të pasurive kapitale. Përkatësisht, në njërin rast ishte regjistruar pagesa në vlerë 19,300€ për një kamion i cili nuk ishte në pronësi të komunës. I njëjti ishte blerë sipas Memorandumit të mirëkuptimit mes Komunës, Kompanisë Rajonale të Mbeturinave (KRM) Uniteti dhe GIZ-it gjerman për bashkëfinancimin e blerjes së tre kamionëve me qëllim të zgjerimit të ofrimit të shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave, dhe i cili sipas marrëveshjes duhej të regjistrohej në pronësi të KRM Uniteti. Ndërsa në rastin tjetër kemi evidentuar se shpenzimet për kontratën "Rregullimi i një depo në objektin e komunës" prej 3,185€ ishte regjistruar gabimisht dy herë, njëri regjistrim është bërë me ID 58119 sipas vlerës së punëve të kryera dhe pranuar teknikisht prej 3,075€ dhe regjistrimi tjetër ishte bërë sipas vlerës së kontratës prej 3,185€ me ID 59436. Në regjistër të pasurive duhet të mbetet vetëm regjistrimi sipas vlerës së punëve të kryera dhe pranuar teknikisht prej 3,075€.

Regjistrimet e gabuara kryesisht ishin për shkak të volumit të madh të punëve në fund vit dhe mungesës së njohurive lidhur me kërkesat e rregullores për menaxhimin e pasurive.

<sup>15</sup> Asfaltimi i rrugës Klinë-Prekaz 70,437.4€; Asfaltimi i rrugës në Kopiliq lagjia Havolli 5 pagesa: 21,629€, 19,860€, 16,107.88€, 14,663.87€ dhe 3,160.61€; Ridizajnimi i zyrave në administratën komunale dy pagesa: 1,937.35€ dhe 6,863.63€

<sup>16</sup> Mirëmbajtja investive 11,807.5€ dhe 3,192€

---

**Ndikimi** Mungesa e regjistrave të saktë dhe të plotë shkakton mungesë të informatave për menaxhmentin lidhur me pasurinë që posedon komuna, shkakton mbi/nënvlerësim të pasurive si dhe mund të rezultojë në prezantimin jo të drejtë të informatave në pasqyra financiare. Ndërsa mos krahasimi i inventarizimit me gjendjen e regjistrave të pasurive dhe mos vlerësimi i pasurive nuk jep siguri lidhur me saktësinë dhe plotësinë e regjistrave të pasurisë.

**Rekomandimi C3** Kryetari, duhet të sigurohet që do të bëhet azhurnimi i regjistrit të pasurive kapitale konform gjetjeve të auditimit të trajtuara me lartë për të siguruar se të gjitha pasuritë e komunës janë identifikuar dhe regjistruar saktë në regjistrat përkatës të pasurive komunale. Po ashtu duhet siguruar se procesi i inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive do të kryet sipas kërkesave të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore.

## 2.3 Të arkëtueshmet

Në PFV-të e vitit 2019, komuna ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 1,131,426€. Kjo vlerë përbehet nga të arkëtueshmet e tatimit në pronë, taksa në biznes, shfrytëzimi i pronës publike, renta dhe qiraja.

---

### Çështja C4 - Inkasim i ulët i llogarive të arkëtueshme

**Gjetja** Përkundër të trendit të zvogëlimit të llogarive të arkëtueshme në krahasim me vitin e kaluar, edhe gjatë vitit 2019 nuk kishte menaxhim efektiv në mbledhjen e tyre. Të gjeturat i prezantojmë si në vijim:

- Nga 17 mostra e testuara të tatimit në pronë, kemi evidentuar vonesa të konsiderueshme në inkasimin e tyre, të cilat janë borxhe të vjetra nga viti 2005 e tutje. Prej tyre, dy raste në vlerë prej 14,252€ kishin të bënin me të arkëtueshmet e ndërmarrjeve shoqërore të përfshira në procesin e privatizimit nga AKP. Kurse 13 raste të tjera janë vonesa në pagesa nga qytetarë dhe biznese në vlerë prej 31,373€, përkundër kërkesave të nenit 23 të ligjit Nr. 06L/005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme si dhe marrëveshjeve të nënshkruara mes tatim paguesve dhe komunës për shlyerjen e borxheve me këste.
- Nga testimi i tri mostrave të taksave në biznes në vlerë prej 7,854€, dhe tri mostrave të shfrytëzimi i pronës publike në vlerë prej 21,650€, kemi vërejtur që janë borxhe të akumuluar ndë vite, përkundër rregullores për taksa dhe tarifa ku përcaktohen kriteret e pagesave si dhe vërejtjeve ndaj tyre, nuk janë zbatu të gjithë mekanizmat e mundshëm për mbledhjen e tyre.

- Përderisa disa llogari menaxhohen nga sisteme të integruara (tatimi në pronë, taksa në biznes), llogaritë tjera menaxhohen në Excel dhe të dhënat e prezantuara nuk japin siguri për saktësinë dhe plotësinë e tyre.

Të gjeturat e mësipërme janë shfaqur për shkak se komuna nuk kishte ndërmarrë veprime të mjaftueshme për inkasimin e të hyrave nga borxhet e paraqitura në llogaritë e arkëtueshme.

## **Ndikimi**

Mungesa e veprimeve konkrete për arkëtimin e llogarive të arkëtueshme mund të rezultojë me rritje të këtyre llogarive, rrezikon që komuna të ketë humbje financiare si dhe rrezikon mos realizimin e projekteve të komunës të financuara nga të hyrat vetjake. Mungesa e softuerëve/data bazës funksionale rrezikon saktësinë dhe plotësinë e informatave për të arkëtueshmet dhe shpalosjen e tyre në PFV.

**Rekomandimi C4** Kryetari, duhet të sigurojë efikasitet më të lartë në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme. Hartimi dhe aplikimi i programeve dhe procedurave të qarta për mënyrën e menaxhimit dhe arkëtimit të tyre, do të ndihmonte në këtë drejtim.

## **2.4 Detyrimet**

### **2.4.1 Detyrimet e papaguara**

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2019, ishte 55,860€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2020.

#### **Çështja B6 - Menaxhimi dhe raportimi i obligimeve të papaguara**

##### **Gjetja**

Sipas Rregullës financiare nr. 02/2013/MF për raportimin e obligimeve të papaguara të OB-ve, neni 5 pika 3 precizohet që "Raporti mujor i obligimeve të papaguara", duhet të përfshijë gjendjen e obligimeve të periudhës raportuese, përfshirë këtu të gjitha obligimet, pa marrë parasysh se në cilën periudhë kanë ndodhur". Po ashtu, OB duhet që çdo faturë të vlefshme për pagesë, ta paguaj brenda 30 ditësh kalendarike nga data e pranimit të faturës. Ne kemi vërejtur se:

- Vlera e obligimeve të raportuara për muajin dhjetor në MF ishte 9,749€, kurse vlera e obligimeve në PFV ishte 55,860€. Gjatë analizës së kësaj diference ne identifikuam se raportimet mujore në thesar paraqiten vetëm si obligime të muajit përkatës e jo siç kërkohet me rregullore që edhe obligimet e muajve paraprak që nuk janë paguar të përfshihen në raport; dhe

- Nga 7 rastet e testuara, në dy prej tyre me vlerë 50,206€<sup>17</sup> kishte vonesa në pagesat e faturave, njëra 160 ditë dhe tjetra 217 ditë vonesë. Vonesat në pagesat e faturave kanë rrjedhur si shkak i mungesës së alokimit të mjeteve.

**Ndikimi**

Kontrollet e dobëta në menaxhimin dhe raportimin e obligimeve mujore, paraqesin pasqyrim jo të drejtë të obligimeve, ndërsa vonesat në pagesa krijojnë implikime buxhetore për vitin fiskal vijues si dhe mundësinë e ekzekutimit të pagesave direkt nga Thesari.

**Rekomandimi B6** Kryetari, duhet të sigurojë kontrole në ekzekutimin e pagesave, dhe në rast të paraqitjes së obligimeve të komunës, ato të jenë raportuar në mënyrë të plotë duke përfshirë të gjitha obligimet pa marrë parasysh se në cilën periudhë kanë ndodhur.

## 2.4.2 Detyrimet kontigjente

Pasqyra e detyrimeve kontigjente në fund të vitit 2019 ishte 849,748€. Kemi testuar 5 mostra nga kjo kategori në vlerë 425,023€.

## 2.4.3 Detyrimet kontraktuale

Sipas të dhënave që na janë ofruar nga komuna, gjendja e detyrimeve kontraktuale deri me datën 31.12.2019 ishte 4,562,617€. Kjo vlerë është nxjerrë nga lista e bashkëfinancimeve dhe raporti vjetor për kontratat e nënshkruara publike.

---

<sup>17</sup> Fatura për mirëmbajtjen e rrugëve lokale në vlerë 46,723€ dhe Fatura për shërbimet të shtypjes-jo marketing në vlerë 3,483€

---

## 2.5 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me dy anëtarë - drejtori dhe një auditor. Përveç planit strategjik, NjAB kishte hartuar edhe planin vjetor të punës ku ishin përfshirë shtatë (7) auditime. Të gjitha këto auditime ishin përfunduar, si dhe dy auditime tjera sipas kërkesës së Kryetarit. Numri i rekomandimeve të dhëna në raportet e auditimit është 36, të zbatuara ishin 20, në proces ishte 10 dhe 6 të pazbatuara.

Auditimet ishin fokusuar në fushën e prokurimit, pasurive, shpenzimeve për mallra/shërbime dhe komunal, tatimit në pronë, sistemit të pagave dhe mëditjeve dhe subvencioneve. Përderisa periudha e mbuluar me auditim ishte kryesisht viti 2019.

Komiteti i auditimit nuk ishte plotësisht funksional dhe kishte mbajtur tre (3) takime ku ishte diskutuar për raportin e auditorit të jashtëm dhe të NjAB-së, me fokus në implementimin e rekomandimeve të dhëna nga ZKA.

---

### Çështja C5 - Mos kompletimi i NjAB-së

- Gjetja** Neni 5.1.1 i Rregullores 01/2019 për themelimin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm përcakton që çdo subjekti i sektorit publik me buxhet mbi 7 milion€ duhet të ketë së paku tre auditorë. NjAB në Komunën e Skënderajit përbëhet nga drejtori dhe një anëtar.
- Ndikimi** Mos kompletimi i NjAB me staf të mjaftueshëm, mund të ndikojë që auditimi i brendshëm mos të mbulojë të gjitha fushat me rrezik, dhe t'i pamundësoj menaxhmentit marrjen e veprimeve me kohë për parandalimin e gabimeve të mundshme.
- Rekomandimi C5** Kryetari, duhet të sigurojë se për pozitat e kërkuara do të bëhen planifikimet buxhetore me kohë dhe se Njësia e Auditimit të Brendshëm do të plotësohet me staf të mjaftueshëm sipas rregullores në fuqi.

### 3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e Komunës së Skënderajit për vitin 2018 ka rezultuar me 18 rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Komuna po ashtu ka përgatitur raportin periodik për zbatimin e rekomandimeve (30 shtator dhe 15 mars) sipas kërkesave të dalura nga Rregullorja e Punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit. Megjithatë konstatimet e zyrtarëve komunal lidhur me implementimin e rekomandimeve nuk përputhen plotësisht me gjendjen e konstatuar nga auditimi.

Sipas vlerësimeve të komunës në raportin e zbatimit të rekomandimeve, 8 janë në proces të zbatimit dhe 10 janë zbatuar, derisa ne kemi vlerësuar se deri në fund të auditimit tonë për vitin 2019, 4 rekomandime janë zbatuar, 5 ishin në proces, 6 nuk janë zbatuar, dhe 3 rekomandime konsiderohen të mbyllura. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4.

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2019

Nr.	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2018	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	PFV	Kryetari, duhet të siguroj se janë ndërmarrë veprime për t'i adresuar shkaqet, për Theksim të Çështjes në opinionin e auditimit. Kjo kërkon veprime konkrete për të siguruar në vazhdimësi menaxhimin dhe regjistrimin e plotë të pasurisë në SIMFK përfshirë edhe shpalsjen e drejtë të tyre në PFV.	Komuna ka ndërmarrë masa për ndërtimin e një depo, janë vendos barkodet, mirëpo ende ka mangësi në regjistrimin e pasurive.	Rekomandim i mbyllur  Rekomandim i është dhënë në fushën e pasurisë
2	Planifikim i dhe realizimi i buxhetit	Kryetari duhet të sigurohet që planifikimet për shpenzime të bëhen konform kodeve ekonomike të ndara për kategori përkatëse varësisht përfitimeve.	Nuk janë përsëritur disa keqklasifikime të shpenzimeve kapitale të cilat ishin bërë nga M&Sh, mirëpo ka keqklasifikime tjera tek M&Sh dhe subvencionet, si shpenzimet e varrimit, kujdesit shëndetësor dhe keq-klasifikimet sipas vendimeve gjyqësore.	Rekomandim në proces të zbatimit Ref C1
3	Të Hyrat	Kryetari duhet të sigurojë që zyrtarët	Gjatë auditimit,	Rekomandim

		përgjegjës aplikojnë shtojcat e parapara me UA që e rregullojnë çështjen e lejeve ndërtimore, me qëllim që kur kërkesat për leje janë të pakompletuara, aplikuesit të njoftohen me kohë me qëllim të evitimit të vonesave në dhënien e përgjigjes për leje ndërtimore nga ana e Komunës	kemi hasur se shtojcat 5 dhe 8 kanë filluar të përdoren, kurse lejet ndërtimore në mostrat e testuarajanë lëshuar me kohë.	i zbatuar
4	Pagat dhe Mëditjet	Kryetari, duhet të siguroj se marrëveshjet për shërbime të veçanta janë për punë specifike dhe për to zhvillohet një procedurë e thjeshtuar e rekrutimit dhe kontratat nuk zgjasin më shumë se afati i paraparë ligjor. Po ashtu, duhet të ndërmerren veprime që nevojat për pozitat të rregullta të adresohen në MF gjatë planifikimit buxhetor me qëllim që këto të mos mbulohen me MSHV.	Edhe këtë vit gjendja është njëjte	Rekomandim i pa zbatuar Ref. B1
5	Mallra dhe Shërbime	Kryetari, duhet të sigurojë kontrolle shtesë përgjatë procedurave të prokurimit për të siguruar se ato zhvillohen komfor kërkesave ligjore dhe ofrojnë vlerë të shtuar për paranë e shpenzuar. Për më tepër, si në rastin e cekur, kriteret mbi përcaktimin e çmimeve sipas rëndësisë së artikujve duhet të jenë vendosur, në mënyrë që të ketë bazë përcaktuese për përzgjedhjen e OE.	Nuk kemi hasur raste të tilla gjatë këtij viti.	Rekomandim i zbatuar
6	Mallra dhe Shërbime	Kryetari duhet të forcojë kontrollin në departamentin e prokurimit, duke siguruar që zyrtari përgjegjës i prokurimit vetëm pas plotësimit të kriterëve, të shpërblej me kontratë OE. Po ashtu, përzgjedhja e komisioneve të vlerësimit duhet të jetë sa më profesionale me qëllim që vlerësimi tenderëve të bëhet në harmoni të plotë me kriteret dhe dëshmitë e kërkuara në dosje të tenderit.	Nuk kemi hasur raste të tilla gjatë këtij viti.	Rekomandim i zbatuar
7	Mallra dhe Shërbime	Kryetari duhet të forcojë kontrollet për të siguruar se para përgatitjes së projekteve bëhen analiza të mjaftueshme lidhur me nevojat për furnizimet/punët e kontraktuara. Në këtë mënyrë do të përmirësohet menaxhimi i kontratave dhe do të shmangen rastet e tejkalimit mbi normën e lejuar +/-30%.	Nuk janë marrë masa	Rekomandim i pa zbatuar

8	Mallra dhe Shërbime	Kryetari duhet të siguroj që me rastin e furnizimeve, pranimi i tyre të bëhet nga menaxherët/komisionet përkatëse dhe të sigurohet që ndarja e detyrave dhe përgjegjësive në aktivitetet e prokurimit të bëhet në përputhje me kërkesat ligjore, në mënyrë që të shmangët mundësia e konfliktit të interesit.	Sa i përket mungesës së raporteve të menaxhereve gjendja është e njëjtë edhe këtë vit, kurse nuk kemi hasur raste të konfliktit në ndarjen e detyrave.	Rekomandim në proces të zbatimit Ref C2
9	Investimet Kapitale	Kryetari duhet të siguroj përmes menaxherit të prokurimit që gjatë aplikimit të procedurave të negociuara të mbajnë evidenca të negociatave dhe të kujdesen maksimalisht që kostoja e kontratave me këtë procedurë të jetë kosto sa më e ulët për autoritetin kontraktues ashtu siç e parasheh baza ligjore. Ndjekja e trajnimeve dhe marrja e sqarimeve nga institucionet kompetente të prokurimit do të mund të rriste kompetencën.	Nuk kemi hasur raste të tilla gjatë këtij viti	Rekomandim i zbatuar
10	Investimet Kapitale	Kryetari, duhet të sigurojë një shqyrtim detal të arsyeve që kanë shkaktuar vonesat në realizimin e projekteve dhe të ndërmerr masat e nevojshme në mënyrë që ato të përfundohen brenda afateve të arsyeshme kohore duke shmangur bartjen e tyre në periudhat e ardhshme.	Edhe në këtë vit gjendja është e njëjtë, kemi identifikuar raste të vonesave në realizimin e projekteve.	Rekomandim i pa zbatuar Ref B4
11	Çështjet e përbashkëta M&Sh- IK	Kryetari duhet të sigurojë bashkëpunim me MF ashtu që obligimet që dalin nga marrëveshja kolektive të planifikohen/buxhetohen dhe paguhen në kohën e duhur nga kategoria e pagave dhe mëditjeve. Gjithashtu obligimet të paguhen brenda afateve kohore të parapara ligjore sipas LMFP.	Edhe në këtë vit gjendja është e njëjtë	Rekomandim i pa zbatuar Ref B5
12	Çështjet e përbashkëta M&Sh dhe IK	Kryetari duhet të sigurojë përmes menaxherit të prokurimit procedimin e njoftimit për nënshkrim të kontratës dhe se kontrollet në ekzekutimin e pagesave janë duke u respektuar në vazhdimësi për tu siguruar që malli/fatura nuk duhet pranuar para se të jetë proceduar urdhër blerja.	Njoftimi për nënshkrimin e kontratave ishte bërë, ndërsa Urdhërblerjet pas faturës vazhdojnë të aplikohen edhe këtë vit. Rekomandimi në lidhje me këtë	Rekomandim i mbyllur

			është dhënë në Letërmenaxhment.	
13	Pasuritë	Kryetari duhet të siguroj funksionalizimin dhe përdorimin e plotë të sistemit E-pasuria për regjistrimin e pasurive nën 1,000€ dhe stoqeve si dhe të funksionalizoj depon për menaxhimin e stoqeve. Po ashtu, duhet siguruar trajnime të zyrtarit të pasurisë për një menaxhim më të mirë të pasurisë.	Komuna ka ndërtuar një depo, mirëpo problemet me funksionimin e e-pasurisë janë evidente edhe këtë vit.	Rekomandim në proces të zbatimit Ref C3
14	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë se personat përgjegjës që menaxhojnë kontratat e komunës janë të përgjegjshëm dhe llogaridhënës dhe pagesat aprovohen nga organi mbikëqyrës vetëm pas pranimit të punëve të përfunduara. Gjithashtu pasurive duhet të ju vendosen barkodet dhe të regjistrohen në SIMFK ndaras e jo si vlerë totale e projektit.	Pagesa për punë të pakryera janë evidentuar edhe këtë vit	Rekomandim i pa zbatuar B3
15	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të sigurojë efikasitet më të lartë në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme dhe procedura të qarta për mënyrën e menaxhimit dhe arkëtimit të borxheve. Posedimi i një softueri/data baze do ta lehtësonte punën dhe mirëmbajtjen e këtyre llogarive.	Nuk ka rritje të LLA, mirëpo ka inkasim të dobët të tyre, si dhe mungesë të softuerit.	Rekomandim në proces të zbatimit Ref C4
16	Obligimet	Kryetari, duhet të sigurojë kontrolle në ekzekutimin e pagesave, dhe në rast të paraqitjes së obligimeve të komunës, ato të jenë raportuar në mënyrë të plotë duke përfshirë të gjitha obligimet pa marrë parasysh se në cilën periudhë kanë ndodhur	Edhe këtë vit gjendja është e njëjtë. Raportet mujore të faturave nuk përfshijnë edhe faturat të muajve paraprak që nuk janë paguar, po ashtu kishte vonesa në pagesën e faturave më shumë se 30 ditë.	Rekomandim i pa zbatuar Ref B6
17	Sistemi i Auditimit të brendshëm	Kryetari, duhet të sigurojë se për pozitat e kërkuara do të bëhen planifikimet buxhetore me kohë dhe se Njësia e Auditimit të Brendshëm do të plotësohet me staf të mjaftueshëm sipas UA në fuqi.	Komuna ka angazhuar një staf shtesë në NjAB, mirëpo prap nuk është mjaftueshëm sipas kërkesave ligjore.	Rekomandim në proces të zbatimit. Ref: C5

18	Raportimi menaxherial	Kryetari, duhet të sigurojë vendosjen e proceseve efektive të menaxhimit të rrezikut nëpër sektorët përkatës të organizatës, të siguroj se është përcaktuar forma e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë.	Gjendja është e njëjtë edhe këtë vit	Rekomandim i mbyllur
Nr.	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2019		
1	Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Kryetari i komunës duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet/kategoritë adekuate të buxhetit (apo të ridestinohen mjetet kur është e nevojshme dhe e mundëshme), dhe që pagesa e regjistrimi i shpenzimeve të bëhet në mënyrë strikte sipas kodeve ekonomike adekuate.		
2	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të siguroj se MSHV përdorën vetëm për punë specifike dhe kontratat nuk zgjasin më shumë se afati i paraparë ligjor. Po ashtu, duhet të ndërmerren veprime që nevojat për pozitat të rregullta të adresohen në Ministri të Financave gjatë planifikimit buxhetor dhe të sigurohet se buxhetohen dhe paguhen nga kategoria e pagave e mëditjeve.		
3	Mallra dhe Shërbime	Kryetari i komunës duhet sigurohet se gjatë përgatitjes së kontratave publike kornizë nga zyra e prokurimit, të përcaktohen saktë njësitë dhe çmimet e kontratave, devijimi +/-30% të përcaktohet në vlerën indikative e jo në vlerën e parashikuar të kontratës, si dhe të marrë të gjitha masat e nevojshme që përmes raporteve periodike nga menaxherët e kontratave të mënjahohen tejkalimet eventuale të kontratave.		
4		Kryetari duhet të siguroj që menaxhimi i kontratave bëhet përmes hartimit të raporteve nga menaxherët përkatës për çdo lloj shërbimi dhe furnizimi, dhe se asnjë pagesë të mos ekzekutohet pa u siguruar dëshmitë e mjaftueshme se dispozitat e kontratës po zbatohen nga ana e operatorëve ekonomik (OE).		
5		Kryetari duhet sigurojë që do të kryhet servisimi i të gjitha aparateve të parapara sipas kontratës, dhe se zyrtarët përgjegjës në menaxhimin e kontratave dhe çertifikim të pagesave aplikojnë kontrolle efektive në procesin e shpenzimit të parasë publike për tu siguruar se në të ardhmen nuk do të përseriten gabimet e ngjashme.		
6		Kryetari duhet të forcojë kontrollin në departamentin e prokurimit, për të siguruar që zyrtarët përgjegjës, të gjitha kërkesat për sqarime të tenderit dhe përgatitjen e dosjeve të tenderit/njoftimit për kontratë t'i bëjnë sipas kritereve të parapara ligjore.		
7	Subvencione dhe Transfere	Kryetari duhet të sigurojë që procesi i vlerësimit të aplikuesve të dokumentohet me dëshmi përkatëse duke siguruar në të njëjtën kohë të mos shkelet parimi i konkurrencës dhe trajtimit të barabartë të aplikuesve.		
8	Investime Kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se menaxherët e projekteve janë në njohuri me kërkesat ligjore për prokurimin publik (kjo mund të bëhet me anë të trajnimeve) dhe se çdo ndryshim në kushtet e kontratës para ose gjatë periudhës së zbatimit do të bëhet vetëm pas njoftimit të zyrës së prokurimit		

		dhe marrjes së aprovimit nga zyra e prokurimit dhe ZKA.
9		Kryetari duhet të sigurojë që kontratat të nënshkruhen vetëm atëherë kur ekzistojnë fonde të mjaftueshme që sigurojnë ekzekutimin e tyre, pa marrë parasysh nëse financimi i tyre është nga të hyrat vetanake apo fonde tjera të financimit.
10		Kryetari duhet të siguroj se menaxherët e kontratave dhe çertifikuesi aplikojnë kontrolle efektive në procesin e shpenzimit të parasë publike për tu siguruar se pagesat bëhen vetëm për punët/furnizimet e realizuara. Po ashtu, për punët e pakryera por të paguara, komuna duhet të sigurohet se do të bëhet realizimi i tyre sipas kushteve kontraktuale, në të kundërtën duhet të bëhet kthimi i mjeteve financiare në buxhetin e komunës.
11		Kryetari duhet të siguroj që mos të fillohen projektet pa u siguruar për çështjet e problemeve pronësore. Të hartohen specifika adekuate të projekteve dhe menaxherët e kontratave të aplikojnë kontrolle efektive në menaxhimin e kontratave për tu siguruar se ato menaxhohen sipas planifikimeve të bëra paraprakisht. Duhet formalizuar procesin e zgjatjes së periudhës së ekzekutimit të kontratës sipas nenit 18 të dosjes së tenderit, si dhe të aplikohen penalet për vonesat e pa arsyetuara.
12	Çështjet e përbashkëta M&Sh dhe IK	Kryetari duhet të sigurojë bashkëpunim me MF ashtu që obligimet që dalin nga marrëveshja kolektive të planifikohen/buxhetohen dhe paguhen në kohën e duhur nga kategoria e pagave dhe mëditjeve. Gjithashtu obligimet të paguhen brenda afateve kohore të parapara ligjore sipas LMFP
13	Pasuritë Kapitale dhe Jo kapitale	Kryetari, duhet të sigurohet që do të bëhet azhurnimi i regjistrit të pasurive kapitale konform gjetjeve të auditimit të trajtuara me lartë për të siguruar se të gjitha pasuritë e komunës janë identifikuar dhe regjistruar saktë në regjistrat përkatës të pasurive komunale. Po ashtu duhet siguruar se procesi i inventarizimi dhe vlerësimit të pasurive do të kryet sipas kërkesave të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore.
14	Të Arkëtueshmet	Kryetari, duhet të sigurojë efikasitet më të lartë në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme. Hartimi dhe aplikimi i programeve dhe procedurave të qarta për mënyrën e menaxhimit dhe arkëtimit të tyre, do të ndihmonte në këtë drejtim.
15	Detyrimet	Kryetari, duhet të sigurojë kontrolle në ekzekutimin e pagesave, dhe në rast të paraqitjes së obligimeve të komunës, ato të jenë raportuar në mënyrë të plotë duke përfshirë të gjitha obligimet pa marrë parasysh se në cilën periudhë kanë ndodhur.
16	Auditimi i brendshëm	Kryetari, duhet të sigurojë se për pozitat e kërkuara do të bëhen planifikimet buxhetore me kohë dhe se Njësia e Auditimit të Brendshëm do të plotësohet me staf të mjaftueshëm sipas rregullores në fuqi.

---

## Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pamodifikuar** nëse arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse Pasqyrat Financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në Pasqyrat Financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale, por nuk janë përhapur në Pasqyrat Financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të

---

cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë materiale, por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në Pasqyrat Financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë, edhe materiale, edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi Pasqyrat Financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

*Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit*

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë Pasqyrat Financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhen t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të Pasqyrave Financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

---

## Shtojca II: Letër e konfirmimit



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
KUVENDI KOMUNAL/ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPŠTINA OPSHINA  
SKENDERAJ

Nr. 02-400/01-0028436/20  
Data 24.07.2020

Date



Komuna Skenderaj  
Opština Skenderaj  
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

DATË/A:	24.07.2020
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Zyrën e Kombëtare të Auditimit
NGA/OD/FROM:	Kryetari i Komunës së Skenderajt, z. Bekim Jashari
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Letër e konfirmimit për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2019 dhe për implementimin e rekomandimeve

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Skenderajt, për vitin 2019 (në tekstin e mëtejshëm “Raporti”);
- Pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Me respekt,